



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 49, datë 20 .11. 2012

**PËR  
“ZËVENDËSIMIN DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE TË RINJ TË KËSHILLIT  
MBIKQYRËS TË SHOQËRISË KLUBI I FUTBOLLIT TIRANA SHA”**

Në mbështetje të nenit 8/1/I”b”, të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), nenit 135, pika 2 shkronja “c”, nenit 155, pika 2 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 për “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), nenit 44 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 për “Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), nenit 13 e 23 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.14, datë 12.10.2011, për “Transformimin në shoqëri aksionare të Klubit të Futbollit Tirana, miratimin e aktit të themelimit dhe stututit të Shoqërisë Aksionare “Klubi i Futbollit Tirana”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I**

1. Të rritet numri i anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë “Klubi i Futbollit Tirana” sha., nga 9 anëtarë në 11 anëtarë.
2. Të shkarkohet si anëtar i Këshillit Mbikqyrës z. Marenglen Shyti dhe në vend të tij të emërohet z. Etion Kapedani.
3. Të shkarkohet si anëtar i Këshillit Mbikqyrës z. Krenar Alimehmeti dhe në vend të tij të emërohet z. Nuri Bylyku.
4. Të emërohet si anëtar i Këshillit Mbikqyrës z. Niazi Kosovrasti.
5. Të emërohet si anëtar i Këshillit Mbikqyrës z. Petrit Vasili.
6. Ngarkohet administratori i klubit të bëjë rregjistrimin e vendimit për “Zëvendësimin dhe emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë Klubi i Futbollit Tirana sha” pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
7. Ngarkohet shoqëria “Klubi i Futbollit Tirana” sha., për zbatim e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**NIAZI KOSOVRASTI**